

STATUT
I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“REJGI-15” SH.P.K.

Statuti i Shoqerise eshte akti baze ku do te mbeshtetet ajo per organizimin dhe zhvillimin e veprimtarise. Ky statut perpilohet nga Ortaku i Vetem i Shoqerise:

Elton HARAÇIU, i biri i Reis, i datelindjes 22.06.1986, lindur ne Kastriot, dhe banues ne Peshkopi, i pajisur me leternjoftimin nr. 032973265, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

KREU 1
FORMA, EMERTIMI, KOHEZGJATJA, SELIA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria fiton personalitetin juridik qe nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me me Ligjin Nr.9723, datë 3.5.2007 “PËR QENDRËN KOMBËTARE TE REGJISTRIMIT”, duke marre persiper te drejta dhe detyrime. Shoqeria eshte person juridik shqiptar ,zhvillon aktivitetin ekonomik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe te akteve te tjera themelore te ligjes.

NENI 2

Shoqeria eshte formes se Shoqerive Tregtare Private me pergjegjesi te kufizuar dhe e emertuar Shoqeria Tregtare Private “REJGI-15” SH P K .

NENI 3

Veprimtaria e Shoqerise shtrihet ne nje kohezgjatje pa afat.Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak me vendim te asamblese se ortakeve ose sipas ligjit .

NENI 4

Shoqeria do te kete qendren e saj ne Adresen : Qyteti: Peshkopi, Lagja "Gjok Doçi" , Rr. “ Tercilio Kardinali”
Ndertesa me nr. 22, Pasuaria me nr. 13/208 –ND, ndodhur ne zonen kadastrale 2932.

Selia dhe Zyra Qendrore,jane atje ku do te zhvillohet edhe pjesa kryesore e veprimtarise, ne perputhje me nenin 2, te Ligji 9901 date 14.04.2008.

Shoqeria mund te hape dhe vendqendrim te tjera te dyta .

Ne rast se hapen Dege te tjera ,keto dege aktiviteti i saj do te shtrihet brenda dhe ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise.

Çdo ndryshim i selise behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.



NENI 5

OBJEKT i Shoqerise do te jete: “ Import – Eksport” te produkteve ushqimore me origjine jo shtazore”

NENI 6

Per kryerjen e veprimtarise se saj te parashikuar ne objekt shoqeria do te lidhe kontrata te ndryshme me personat fizike ose juridike ose mund te krijoje qendra grumbullimi nese do te jete e nevojshme.

KREU II

KAPITALI THEMELOR

NENI 7

Kapitali themelor i Shoqerise eshte 100.000 leke(njeqind mije) i ndare ne 1 kuote te vetme, me vlere 100 000 leke.

Kjo derdhje eshte ne perputhje me Nenin 35 te Ligjin Nr.9901 datë 14.4.2008 ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ”.

Zotërimi i kuotave

Kuotat zoterohen 100 % nga ortku themelues i vetem z.Elton HARAÇIU.

NENI 8

Shoqeria mund te rrise kapitalin e saj themelor gjate aktivitetit te saj .Shtimi ose pakesimi i kapitalit behet me vendim te asamblese se ortakeve.Kufiri I pakesimit te kapitalit themelor eshte ne perputhje me nenin 70 te Ligjit Nr.9901 datë 14.4.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,ne lidhje me minimumin e mundshem te tij.

NENI 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

2. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të zbatohet e drejtat e parablerjes kundrejt ortakut tjetër i cili duhet të refuzojë me shkrim, para se kuotat të tjetërsohen në favor të një personit të tretë.

Pasojat e kalimit të kuotave

2. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesëtimi i kuotave dhe transferimi i tyre

1. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

2. Zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave Dispozitat e nenit 73 të ligji 9901 Date 14.4.2008.

NENI 10 ADMINISTRATORI

Ortakët emerojnë administrator të Shoqërisë Z.Elton HARAÇIU me afat pesë vjeçar i cili do të jetë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë me të drejta për të vepruar sipas ligjit në lidhje me kompetencat e administratorit.

NENI 11

Ortakët në përputhje me nenin 43 pika b të L.nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", mund të emerojnë një apo disa eksperte kontabel të autorizuar për të kryer bilancin dhe llogaritjet vlerën e të ardhurave dhe operacioneve të tjera financiare .

Eksperti kontabel ka përgjegjësi në llogaritjet e sakte të bilanceve ,apo veprimeve që lidhen me të , në rast shkaktimi të humbjeve të cilat mund të vërtetohen në gjykatë .Eksperti duhet të përgjigjet për humbjet e shkaktuara.

NENI 12

Kapitali themelor është plotësisht i trashëgueshem në rrugë trashëgimie ,në rast ndarjeje pasurie midis bashkeshortëve dhe midis paraardhësve dhe pasardheve.

NENI 13

Shoqëria në rast vdekjeje të ortakut nuk prishet ,trashëgimtarët e ortakut trashëgojnë kuotat e kapitalit themelor duke siguruar vazhdimësinë e shoqërisë .

NENI 14

Kapitali i shoqërisë përbehet nga kapitali fillestar ,mjetet e xhiros,pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme,asete të tjera që mund të shtohen etj., që nevojiten për zgjerimin e aktivitetit .

NENI 15

Fitimi i realizuar administrohet nga ortakut i vetëm, Z.Elton HARAÇIU, ky fitim mund të perdoret për zgjerimin e aktivitetit tregëtar si dhe për :



- Rezerva ligjore
- Rezerva statutore
- Rezerva per tjera

Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje detyrimet ndaj Shtetit dhe te treteve.

NENI 16

Shoqeria Tregtare Private "REJGI-15" SH P K eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj .Ajo mund te bleje dhe shfrytezoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale duke perfshire te drejten e pasurise se vet tek te tretet .Ne Republikën e Shqiperise gezon te drejta sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 17

Shoqeria merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda mundesive financiare te saj.

NENI 18

Shoqeria eshte pronare e mjeteve te saj.Ajo ka te drejte te perdore dhe te disponoje mjetet e saj ne perputhje me objektin e veprimtarise qe kryen duke i mbrojtur ato sipas dispozitave ligjore.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE ,ORGANET DREJTUESE,ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

NENI 19

Organi drejtues eshte asambleja e pergjitheshme ortakeve ,ne rast se mbetet nje ortak i vetem ,organ drejtues eshte ortaku i vetem,i cili me vendimet e tij individuale ,ushtron kompetencat qe zoteron asambleja e pergjithshme e ortakeve sipas dispozitave Titullit te IV Kreu i pare (Neni 81 e vijues) te ligjit Nr.9901 Date"14.04.2008

NENI 20

ASAMBLEJA E ORTAKEVE ka keto Kompetenca

- a) përcakton e politikat tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e



- pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- I) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - II) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - III) investime;
 - IV) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE

NENI 21

Çdo vit financiar fillon me date 01 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti financiar mund të fillojë pas regjistrimit të Shoqërisë si Person Juridik dhe do të përfundojë me 31 Dhjetor. Llogarite vjetore, Inventaret, raportet të hartuara nga Administratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve vjetore (Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Te Ardhurave dhe Shpenzimeve etj...) bëhet brenda një afati 6-mujor nga data e mbylljes së vitit financiar. Veprimet e Shoqërisë mbyllet në fund të çdo viti duke u bërë bilanci fitim-humbje.

NENI 22

Fitimi i realizuar administrohet prej Ortakeve të shoqërisë. Administratori, kur nuk është edhe ortak i shoqërisë, paguhet në bazë të marrëveshjes dy pjesë dhe dispozitave ligjore në fuqi. Administratori, kur është ortak i shoqërisë, mund të marrë një rrogë, ose kompensim për administrimin e shoqërisë, veçmas fitimit të tij, në bazë të përqindjes së tij si ortak.

NENI 23

Shoqëria ka llogaritur rjedhese në Banke ose në Banka të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mban dokumentacion të rregullt të detyrueshem.

Shoqëria përgjigjet për detyrimet vetëm me pasurinë e saj, me rezervën e kapitalit të saj, dhe këto pasqyrohen në dokumentacionin përkatës.

NENI 24

Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektore të ndryshëm private ose shtetërore si dhe me persona fizike e juridike vendas apo të huaj. Ajo do të përfaqësohet për lidhjet apo zgjidhjet e këtyre kontratave nga administratori i saj. .

KREU V

MAREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

NENI 26

ASAMBLEJA E ORTAKEVE, vendos për shtimin ose pakesimin e numrit të personave të punësuar në Shoqëri.

NENI 27

Mardheniet e punësimit brenda Shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës, që lidhet midis paleve në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Kodin të Punës.

NENI 28

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti, lëshuar nga Asambleja e Ortave ose nga administratori dhe ky largim lidhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje të disiplinës në punë ose dhe me vete kërkesën e të interesuarit.

Largimi nga Shoqëria bëhet pasi të jenë shlyer detyrimet materiale dhe monetare ndaj saj.

KREU VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 29

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur plotësohet qëllimi i saj, parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblese së ortave;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i

veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

e) humbje e kapitalit, shkaqe madhore, (shkatërrim i plote në raste të forcave madhore, terrmet, zjarr, luftë, përmytje, prishja e parashikuar në këto pike, behet vetëm në rast se nuk është kryer sigurimi pranë një shoqërie sigurimi që rimbursion humbjet dhe mundëson riasetimin e shoqërisë).

f) nëse realizohen kushtet sipas nenit 20 pika IV e statutit të Shoqërisë.

Në rast se prishet caktohet një likuidator ose disa likuidatore. Likuidatori ose administratori përgjigjet për pasurinë e Shoqërisë pasi shlyen detyrimet me të tretet, kryen njoftimet e mbylljes dhe behet çregjistrimi i Shoqërisë nga Regjistri Tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Për likuidimin zbatohet ligji Nr.9901 Date 14.4.2008. “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

NENI 30

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe të punësuarëve apo personave të tretë, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim ato do të mbeten në kompetencë të Gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen, kompetenca territoriale përcaktohet sipas natyrës së mosmarrëveshjes në bazë të Kodit të Procedurës Civile.

NENI 31

Asambleja e Ortakëve mund të bëjë në çdo moment ndryshime ose plotësime në Statut mjafton që ato të mos bien ndesh me dispozitat e këtij Statuti.

Ndryshimet apo plotësimet do të behen në të njëjtën mënyrë me të cilën nxirret dhe vete Statuti.

NENI 32

Gjithçka tjetër që nuk është pasqyruar në këtë Statut do të referohet ligji Nr.9901 Date 14.4.2008. “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe akteve të tjera ligjore e nenligjore në fuqi të legjislativitetit shqiptar.

NENI 33

Shoqëria do të ketë vullnet dhe saj, stemen dhe saj që e individualizon në treg, si dhe ben hapjen e llogarive bankare në emër të saj.

NENI 34

Shoqëria fiton zotesinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit sipas Nenit 26, 28, 32, 35 të Ligjit Nr.9723 Date 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, VKM Nr.506 Date 1.8.2007, si person juridik dhe veprimtaria e saj ekonomike fillon me regjistrimin e saj në organin tatimor përkatës.

Ky Statut u perpilua ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje ngelet ne dokumentacionin e Shoqerise.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

ORTAKU I VETEM

Elton HARAÇIU

St. 02.02.2018

Elton Haracu

